

Hyn në fuqi Marrëveshja e Stabilizim Asociimit mes Shqipërisë dhe BE.

Shqipëria nis një tjetër udhëtim drejt BE



Drejtori i Përgjithshëm i BE për Zgjerimin, Z. Michael Leigh, në takim me Kryeministrin Berisha

Një tjetër sfidë dhe rrugë drejt Integritimit Evropian nisi për Shqipërinë me 1 Prill 2009 kur Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) mes Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, e nënshkruar në Qershor 2006, hyn në fuqi. Ky moment shënon fillimin e një ere të re gjatë së cilës detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë si edhe pritshmëritë për arritjet e saj do të jenë më të larta se më parë.

Gjatë vizitës së tij në Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm për Zgjerimin i Komisionit Evropian, Z. Michael Leigh u takua me personalitetet politike kryesore të vendit. Gjithashtu, ai mori pjesë në Konferencën për Bashkërendimin e Donatorëve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë që u organizua nga Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit e Komisionit Evropian dhe nga Qeveria Shqiptare gjatë datave 2 dhe 3 Prill, në Tiranë. Vizita e Z. Leigh

nënvizon peshën e veçantë që MSA-ja ka për marrëdhëniet BE-Shqipëri. Gjithashtu, ajo është treguese e rëndësisë që Komisioni Evropian i jep përkushtimit të vazhdueshëm të të gjitha forcave politike në Shqipëri për reformat. MSA-ja mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian paraqet një marrëdhënie kontraktuale me të drejta dhe detyrime të ndërsjella. MSA-ja përqendrohet te respektimi i parimeve kyçe të demokracisë dhe elementeve thelbësore të tregut të përbashkët të BE-së.

Zona e tregtisë së lirë me BE-në dhe aplikimi i standardeve të BE-së në fushën e konkurrencës, rregullave të ndihmës shtetërore apo pronës intelektuale, së bashku me reformat e hartuara drejt përvetësimit të standardeve evropiane në fusha të tjera do t'i japin Shqipërisë mundësinë t'i afrohet BE-së.

E ardhmja e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë në fokusin e BE

Qeveria shqiptare dhe Komisioni Evropian organizuan së bashku një konferencë mbi "Koordinimin e Donatorëve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi", e cila u mbajt në datat 2-3 prill 2009 në Tiranë. Në një tryezë të përbashkët u mbledhën rreth 200 përfaqësues të institucioneve Financiare, Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, donatorë jashtë vendeve të BE-së dhe përfaqësues nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia.

Qëllimi i Konferencës ishte evidentimi i progresit të bërë në përmirësimin e koordinimit të donatorëve, shkëmbimin e përvojave më të mira, adresimin e mangësive që mbeten dhe dhënia e rekomandimeve praktike lidhur me përmirësimin e mëtejshëm të koordinimit të donatorëve dhe sigurimin e një shpërndarjeje efektive të detyrave ndërmjet donatorëve. Në këtë konferencë u diskutuan masat konkrete në sektorët e arsimit, mjedisit dhe transportit, të cilat luajnë një rol kyç në zhvillimin ekonomik-social dhe në integrimin Evropian dhe rajonal të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë.

Konferenca u drejtua nga Drejtori i Përgjithshëm i Zgjerimit, Z. Michael Leigh, së bashku me Kryeministrin e Qeverisë Shqiptare, Z. Sali Berisha, dhe Ambasadorja e Republikës Çeke, vend i cili kryeson Presidencën e Bashkimit evropian në Shqipëri, Znj. Marketa Fialkova.

Ndihma financiare e Donatorëve ndaj Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë gjatë viteve 2005-2008 ka qenë rreth 20 miliard Euro. Konferenca e fundit e Donatorëve u mbajt në tetor 2008 në Bruksel me iniciativën e Komisionit Evropian. Në vijim të rekomandimeve, konferenca në Tiranë ishte e para që mbahet në një nga vendet përfituese me pjesëmarrjen e 200 përfaqësuesve të Institucioneve Financiare Evropiane, donatorëve jashtë BE si dhe përfaqësuesve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë.

Deklaratë nga Z. Olli Rehn, Komisioneri Evropian për Zgjerimin.



Unë përgëzoj hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit firmosur në Qershor 2006, mes Shqipërisë dhe BE. Hyrja në fuqi e MSA, shënon fillimin e një ere të re gjatë të cilës sfidat me të cilat do përballlet Shqipëria dhe rezultatet e pritura prej saj do jenë më të larta se më parë.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit mes Shqipërisë dhe BE përfaqëson një marrëdhënie kontraktuale, e cila do të thotë të drejta dhe detyrime të përbashkëta për të dyja palët. Fokusi i MSA është respektimi i principeve kyçe të demokracisë si dhe elementëve bazë të cilat janë thelbi i tregut të përbashkët Evropian. Krijimi i një zone të lirë tregtie me BE, aplikimi i standardeve të BE në fushat si ato të konkurrencës, pronësia intelektuale, rregullore të ndryshme shtetërore, si dhe reformat e dizenuara me qëllim arritjen e këtyre standardeve, do i japin Shqipërisë mundësinë e afrit me BE.

BE, nëpërmjet procesit të MSA, do vazhdojë të mbështesë Shqipërinë në progresin e saj drejt Integritimit Evropian. Pjesë kryesore e këtij procesi janë edhe politikat e dizenuara nga BE me qëllim forcimin e bashkëpunimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe të bashkëpunimit rajonal. Me qëllim mbështetjen e kryerjes së reformave të nevojshme, BE ofron programe të Asistencës së Paraanëtarësimit për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, programe të cilat kapin vlera monetare rreth 6,8 miliard euro për periudhën 2009-2012. Konferenca e Tiranës e datës 2-3 Prill, ka si temë kryesore, bashkëpunimin e donatorëve me qëllim forcimin dhe përmirësimin e kësaj asistence.

Edicion Special

Ambasadori Lohan viziton Jugun e Shqipërisë, për të diskutuar zhvillimin dhe asistencën e BE, me biznesin lokal, shoqërinë civile, dhe qytetarët

Per 4 ditë me rradhe Shefi i Delegacionit të Komisionit Evropian në Shqipëri, Ambasadori Helmuth Lohan zhvilloi një tur në jug të Shqipërisë për të parë nga afër projektet e financuara nga BE dhe për të bashkëbiseduar me qytetarët shqiptarë, banorë të këtyre zonave apo përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit, duke iu referuar larmisë së projekteve që BE financojnë në Jug të vendit, që nga mbrojtja e mjedisit deri tek politikat e barazisë gjinore Duke nisur nga Fieri, Vlora, qytezat e bregdetit të Jonit Saranda dhe Gjirokastra por dhe pikat kufitare të Shqipërisë me vendin fqinj Greqinë, Ambasadori Lohan u takua dhe bashkëbisedoi me përfaqësues të bizneseve, shoqërisë civile dhe jetës akademike në Jug të vendit për të diskutuar me ta përfitimet dhe sfidat e procesit të integritimit pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Pjesë e vizitës ishin edhe disa pika të kalimit të kufirit si pjesë e një projekti financues të Komisionit për 10 Pika kalim- kufiri në të gjithë Shqipërinë.



Ndërtimi i unazës në Orikum



Ambasadori Lohan inspekton rrugën Orikum-Vlorë

Komisioni Evropian po mbështet zhvillimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës bregdetare në Jug të Shqipërisë. Si pjesë e këtij program asistence, Komisioni Evropian ka financuar prej një shume rreth 500.000 euro, për ndërtimin e rrugës së Orikumit në Vlorë. Punimet për ndërtimin e kësaj rruge të cilat kanë filluar në 2008, përfshijnë ndërtimin e dy urave si dhe instalimin e 28 shtyllave të ndricimit. Përmirësimi i infrastrukturës do të çojë në zhvillimin

ekonomik, si dhe të turizmit, duke siguruar akses ndaj shërbimeve bazë si për popullsinë vëndase edhe për turistët. Ata që do përfitojnë direkt nga ndërtimi i kësaj rruge, në lidhje me zbutjen e trafikut të rënduar gjatë sezonit turistik, si dhe uljes së ndotjes së ajrit, janë banorët e Orikumit. Në nje plan afatgjatë, kjo rrugë do kontribuojë në ruajtjen e burimeve bregdetare, trashëgimisë kulturore si dhe promovimit të zhvillimit të bregdetit Shqiptar në përgjithësi.

Eliminimi i mbetjeve toksike në Fabrikën e Azotit në Fier.

Fabrika e Azotit në Fier, për vite ka ndotur mjedisin për shkak të mbetjeve toksike, duke vënë në rrezik edhe vetë jetën e banorëve. Problemi kryesor për sa i përket ndotjes së ambientit nga kjo fabrikë vjen nga prodhimi i arsenikut si dhe të mbetjeve të tjera toksike të cilat po dëmtojnë mjedisin e ekspozuar ndaj tyre. Eliminimi i mbetjeve me bazë arseniku, përbën një prioritet për sa i përket uljes së impaktit negative ndaj shëndetit si dhe eliminimit të

zonave të përcaktuar si të nxehta të ndotura. Një projekt i financuar dhe aplikuar nga Komisioni Evropian, me vlerë 1.500.000 euro ka si qëllim eliminimin e këtyre mbetjeve, duke ndërtuar një fabrikë për paketimin ruajtjen dhe depozitimin e materialeve kontaminuese. Implementimi i këtij projekti konstaton në shkatërrimin e këtyre mbetjeve në zona të siguruara, si dhe mbledhjen, depozitimin dhe ruajtjen e tyre në vende të siguruara në baze të standarteve ev-



Ambasadori Lohan viziton Fabrikën e Azotit, Fier

ropiane. Ky projekt pritet të kontribuojë edhe në eliminimin e ndotjes aktuale si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat e ndotura.

Takim me komunitetin e biznesit në Vlorë

Më datë 15 Prill u zhvillua në Vlorë një takim me bizneset vendore ku u diskutua rëndësia e hyrjes në fuqi të MSA-së dhe ndikimet e pritshme për biznesin dhe zhvillimin e përgjithshëm të vendit. Hyrja në fuqi e MSA-së dhe ndikimi i saj i drejtpërdrejt në bisnesin vendas ishin në fokus te diskutimit që ambasadori zhvilloi ne qytetin bregdetar. Z.Lohan u shpreh gjatë këtij takime se : “ Së pari , këto takime janë të domosdoshme për të na ndihmuar të kuptojme shkallën e progresit të arritur në muajt e kaluar për përmirësimin e klimës për biznesin. Së dyti, takime të tilla na japin mundësinë të prezantohemi me ato fusha ku asistenca jonë është më e nevojshme nga ana juaj. Së treti do dëshiroja të



Ambasadori Lohan takon biznesin në Vlorë

shkëmbejm opinionione mbi MSA”. Vlora është një nga qytetet kryesore turistike dhe një nga portet më të mëdha në vënd.

Bisedë me studentët dhe pedagogët në Universitetin Eqerem Çabej, Gjirokastër

Më datë 17 prill, Ambasadori Lohan u takua në Gjirokastër me studentë dhe pedagogë të universitetit Eqerem Çabej si edhe përfaqësues të shoqërisë civile për të diskutuar me ta procesin e integritimit Evropian, vendndodhjen e Shqipërisë në këtë proces si edhe mundësitë që lindin prej tij për grupet pjesëmarrëse. Ambasadori Lohan bëri një prezantim mbi aspektet politike dhe sociale të Zgjerimit, standartet që shqipëria duhet të arrijë për të përmbushur angazhimin e të qenit pjesë e familjes europiane. Z.Lohan e prezantoi audiencën me Aktorët kryesorë në procesin e pranimit, si dhe hapat e negociatave për pranimin. Interes të vecantë studentët shfaqën në lidhje me standartet në fushën e arsimit të lartë por dhe mbi problematika të tjera të cilat lidhen direkt me jetën e tyre si studentë.



Ambasadori Lohan në takim me studentë dhe Akademikë në Gjirokastër

Fushatë ndërgjegjësimi mbi Komunitetin Romë në Shqipëri



Ambasadori Lohan viziton komunitetin Romë në Baltas, Fier

Një takim me komunitetin Rom në Baltas Fier ishte pjesë e axhendës së Ambasadorit Lohan , gjate vizitës së tij 4 ditore në Jug të Shqipërisë.Komisioni Evropain po financoj një projekt prej 82.500 euro me qëllim ndërgjegjësimin mbi barazinë gjinore dhe problemeve të Komunitetit Rom. Ky Komunitet në Shqipëri ka mungesa arsimimi, jeton në kushte shumë të vështira ekonomike, si dhe situatë aspak të favorshme sociale. Kjo si rrjedhojë edhe e mentalitetit mbi rolin inferior të gruas në familje si dhe mungesës së arsimit. Projekti i financuar nga KE do implementohet dhe bashkë-financohet nga Shoqata Shqiptare e Grave të Reja Kristiane .

Sistemi Gjyqësorit

Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit
Forcimi i Kufinjve të Shqipërisë



Pika e kalim Kufirit,
Konispol - Sarandë

Shqipëria ka qënë shumë aktive në përpjekjet e saj për zhvillimin dhe forcimin e pikave të kalimit kufitar në vënd. Në vitin 2003, Qeveria Shqiptare aprovoi Strategjinë Kombëtare për Kontrollin e Kufinjve si dhe Menaxhimin të tyre, strategji e cila u punua me ndimën e komunitetit ndërkombëtar. Krijimi i një sistemi të ri menaxhimi me qëllim forcimin e kufijve përbën një nga prioritetet kryesore të Shqipërisë. Ky projekt është

të pjesë e një projekti asistence të financuar nga Komisioni Evropian me vlera rreth 5,400.000 euro, i cili përfshin 10 pika kalimi kufitar në gjithë Shqipërinë. Në vecanti ky projekt i financuar nga Komisioni Evropian, me vlerë rreth 1,200.000 euro, ka si qëllim forcimin e performancës së operatorëve të policisë kufitare në këto pika kalimi të kufirit. Ky projekt do të përmirësojë kushtet fizike dhe mjetet teknike të oficerëve të policisë kufitare me qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale. Projekti do të rishtë bashkëpunimin ndërmjet agjencive në pikat e kalim kufirit, për të përafërsuar sistemin menaxhues të kufijve me standartet e BE. Qëllimi global i këtij projekti ka si qëllim ndalimin e migracionit të paligjshëm, lëvizjes së tregtisë së paligjshme të mallrave dhe njerzve, forcimin e kapacitetit të kontrollit në kufi si dhe të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Rikonstruksioni i Gjykatës së Sarandës me një fond prej €410 000, financuar nga Komisioni Evropian



Ambasadori Lohan gjatë inaugurimit të Gjykatës së re, Sarandë

Gjatë vizitës së tij 4ditore në jug të vëndit, Shefi i Delegacionit të Komisionit Evropian në Shqipëri, Ambasadori Helmuth Lohan, inaguroi Gjykatën e rikonstruktuar dhe rimobiluar të Sarandës. Problemet kryesore të kësaj ndërtese të mbuluara nga ky projekt kishin të bënin me dhomat e izolimit për të ndaluarit, sistemin e sigurisë, masat antizjarr, rrjetin kompjuterik si dhe lagështirën, carjen e mureve etj. Komisioni Evropian vazhdon financimin e një serie ndërhyrjesh në infrastrukturën e gjyqësorit, ndertimin e kapaciteteve dhe trajnimeve, si pjesë e asistencës për reformat në sistemin gjyqësor Shqiptar. Forcimi i pamvarësisë së gjyqësorit Shqiptar si dhe përmirësimi i efikasitetit në një nga qëllimet kyçe të bashkëpunimit mes Qeverisë Shqiptare dhe BE si pjesë e Marrveshjes së Stabilizim Asociimit. Një infrastrukturë sa më adekuate e gjyqësorit përbën një parakusht për rritjen e efikasitetit si dhe në zhvillimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, imparcial, profesional, transparent dhe modern. Rinovimi i Gjykatës së Sarandës, si dhe atyre të Gjykatës së Apelit në Korçe, Vlore dhe Dibër, është pjesë e Master Planit për Infrastrukturën e Gjyqësorit, i cili ka identifikuar këto gjykata si prioritare ndaj financimeve. Masterplanin i përfunduar nga Komisioni Evropian dhe Autoritetet Shqiptare në 2005, siguron një panoramë të përgjithshme të situatës në gjykatat Shqiptare si dhe ofron rekomandime për investime në këtë sektor për 15 vitet në vijim.

Përmirësimi i sigurisë për qytetarët Shqiptarë.

Rrjeti i të Dhënave për Policinë e Shtetit Shqiptar

Komisioni Evropian ka financuar një projekt me vlerë 5,000.000 euro, me qëllim përmirësimin e të dhënave publike si dhe adoptimin e një rrjeti komunikim të dhënash ëirless për Policinë e Shtetit Shqiptar. Ky projekt përfshin instalimin e pajisjeve ëirless të komunikim me radio, pajisjet e rrjetit si dhe aksesoret e tjerë të nevojshëm për operimin e sistemit. Oficerët e policisë po trajnohen mbi përdorimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e këtyre pajisjeve. Ky projekt do mundësojë komunikimin për policinë në nivel kombëtar, i cili si rrjedhim do cojë në rritjen e shpejtësisë në shkëmbimin e informacionit mes Policisë dhe interlokutorëve të jashtëm. Projekti do të forcojë kapacitetet menaxhuese të kufinjve si dhe do sigurojë bazën për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve teknike të Policisë Shqiptare të Shtetit.



Policia Kufitare trajnohet për përdorimin e pajisjeve të vëzhgimit

Ngritja e kesaj infrastructure do rishtë kapacitetet e policisë duke e kthyer atë në një ndërlokutor të besueshëm për partnerët ndërkombëtarë. Me përfundimin e këtij projekti, Policia Shqiptare e Shtetit do menaxhojë dhe mirembajë këtë rrjet, duke përfshirë mirëmbajtjen e burimeve njerzore, material dhe financiare, pjesë të këtij projekti.

Ju lutem vizitoni faqet e internetit të poshtëshënuara ose kontaktoni Delegacionin e Komisionit Evropian në Tiranë
www.delalb.ec.europa.eu
www.europa.eu
www.ec.europa.eu/enlargement
www.eu2009.cz
 Delegacioni i Komisionit Evropian në Tiranë, Shqipëri:
 ABA Center, Rr. "Papa Gjon Pali II", Kati 17
 Tiranë, Shqipëri

Telefon: (355) 4 2228320 or 2230871 - 2228479 -
 2234284 - 2229851 Fax: (355) 4 2230752 or 2274412
 e-mail: Delegation-Albania@ec.europa.eu
 Botues: Komisioni i Delegacionit Evropian në Shqipëri
Opinionet e shprehura në këtë botim nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëvështrimin e Komisionit Evropian
 Nëse doni të merrni botimin e ardhshëm ju lutem na shkruani në adresën e-mail: suela.thanasi@ec.europa.eu
 ose kontaktoni Delegacionin e Komisionit Evropian në Shqipëri